



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - VENDIM

Nr. ___ Datë ___ / ___ / 2022

“Për një ndryshim në vendimin e Taksave dhe tarifave vendore për tarifën për kopshte dhe çerdhe”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 82/1, pika b, bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022 dhe miratimit të nivelit të “Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Dibër për vitin 2022” me nr.63 datë 24.12.2021:

Kërkojmë:

1- Miratimin e tarifës për kopshtë dhe çerdhe për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë e Dibrës që të paguajnë një tarifë ditore si më poshtë:

- a. 180 lekë për fëmijë në kopshte.
- b. 160 lekë për fëmijë në çerdhe.

2- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Kopshteve, Sektori i Çerdheve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

3-Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse Sektorit Juridik
Elona LUSHA

Drejtori Ekonomik
Mensur Shehi

Përgjegjëse Finance
Erblina SELA

KRYETARI I BASHKISË
Rafiq Spahiu